

RAPORTI I MONITORIMIT PËR PUNËN E KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM

Raporti numër 4

(periudha e raportimit: gusht-nëntor 2017)

Projekti:

Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë

Implementues:

Instituti për të Drejtat e Njeriut



Ky publikim është hartuar në kuadër të Projektit: “Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë”, i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Opinionet dhe qëndrimet e prezantuara në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë çdoherë opinionet dhe qëndrimet e Qeverisë britanike.

Përmbajtja:

Hyrje.....	4
TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM.6	
Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit Gjyqësor të RM.....	6
Llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë.....	7
Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM.....	7
Transparenca dhe llogaridhënia e siguruar përmes mbajtjes së mbledhjeve.....	8
EFEKTIVITETI I PUNËS SË KGJRM.....	9
Zbatimi i procedurës për zgjedhjen e gjyqtarëve.....	9
Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e gjyqtarëve.....	9
Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave.....	10
Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.....	11
Zgjedhja e gjyqtarëve-porotë.....	12
TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E KËSHILLIT PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE DHE PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË GJYQTARIT	15
Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit të Fakteve dhe llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë.....	15
Sigurimi i llogaridhënies ndaj publikut të gjerë.....	15
EFEKTIVITETI I PUNËS SË KËSHILLIT TË FAKTEVE.....	16
Shqyrtimi i iniciativave të paraqitura.....	16
Procedurat sipas iniciativave të paraqitura për përgjegjësinë e gjyqtarit deri te Këshilli i Fakteve.....	16

Hyrje

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është organ i mëvetësishëm dhe i pavarur i cili e siguron dhe garanton pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Kompetencat, mënyrat dhe procedurat e punës së Këshillit Gjyqësor të RM-së rregullohen me Kushtetutën e RM-së, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë¹ dhe Rregulloren e punës së Këshillit Gjyqësor të RM-së.² Disa nga kompetencat të cilat janë veçanërisht të rëndësishme në realizimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor të cilat janë objekt i monitorimit, janë: zgjedhja dhe shkarkimi i gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, vlerësimi dhe monitorimi i punës së gjyqtarëve, shqyrtimi dhe vlerësimi i raporteve tremujore dhe vjetore për punën e gjykatave dhe ngjashëm.

Në sistemin e jurisprudencës së RM, nga viti 2015, krahas Këshillit Gjyqësor ekziston edhe Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurave për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit (në tekstin në vijim: Këshilli i Fakteve).³ deri te i cili qytetarët mund të paraqesin parashtrësë për parregullshmëritë në punën e gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave ose për zvarritjen tejmase të procedurave gjyqësore.

Instituti për të Drejtat e Njeriut e implementon Projektin “*Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RM*” i cili ka filluar në shtator të vitit 2016 deri në muajin mars të vitit 2018 dhe i cili ka mbështetje nga Ambasada e Britanisë në Shkup.⁴

Projekti ka për qëllim të kontribuoj në drejtim të transparencës më të madhe, llogaridhënies dhe efektivitetit të punës së Këshillit Gjyqësor të RM-së, si dhe rritjes së vetëdijes publike për punën e Këshillit Gjyqësor të RM. Instituti për të Drejtat e Njeriut, përmes këtij Projekti, e monitoron zbatimin e obligimeve ligjore dhe nivelin e transparencës dhe llogaridhënies së KGJRM, si dhe kontributin për sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit në RM.

1 Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 60/06, 150/10, 100/11,20/2015 dhe 61/2015

2 Rregullorja e Punës së Këshillit gjyqësore, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 197/2015 dhe 12/2017.

3 Ligji për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 20 nga data 12.2.2015.

4 Më shumë informacione për aktivitetet e Projektit janë të aksesshme në internet faqen e Institutit për të Drejtat e Njeriut - www.ihr.org.mk, si dhe përmes aplikacionit mobil “*Këshilli Gjyqësor nën thjerrëz*” - i aksesshëm në Google Play dhe Apple Store.

Ky është **Raporti i katërt i monitorimit** në kuadër të Projektit, i cili e përfshinë periudhën kohore nga muaji **gusht deri në muajin nëntor të vitit 2017**. Raporti i monitorimit për transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e Këshillit Gjyqësor të RM dhe të Këshillit të Fakteve është përpiluar në bazë të Matricës së Monitorimit të indikatorëve të përcaktuar.⁵

⁵ Metodologjia për monitorimin e punës së Këshillit Gjyqësor të RM-së dhe të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve. E aksesshme në: <http://ihr.org.mk/p.php?pid=182>.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM

<p><i>зелено</i> ✓ = plotësisht e përmbushur</p> <p><i>црвено</i> ✗ = e pa përmbushur</p> <p><i>жолто</i> ✓ ✗ = pjesërisht e përmbushur</p>

Ueb faqja www.sud.mk është një platformë e integruar për gjyqësinë, e qartë, por nuk është e lehtë për navigacion dhe nuk i përmban të gjitha informacionet, përkatësisht një pjesë e të dhënave relevante të aksesshme në ueb-faqen e veçantë paraprake www.ssrn.mk nuk janë bartur në këtë platformë.

Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit Gjyqësor

AKTET QË PUBLIKOHEN	STATUSI dhe vërejtjet e përgjithshme
Vendime	Vendimet për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave publikohen në ueb-faqe. Vendimet për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, nga muaji nëntor përmbajnë informacione për të gjithë kandidatët të cilët janë paraqitur, por të njëjtit janë vështirë të aksesshëm, sepse në pjesën “vendime” më të rejtat gjenden në faqen e fundit, ndërsa vendimet më të vjetra janë të para.
Procesverbale	Procesverbalet e mbledhjeve nuk publikohen ⁶
Komunikata për mbledhjet e konvokuara	Komunikatat për mbledhjet e konvokuara publikohen rregullisht në internet faqen e re www.sud.mk në pjesën “Këshilli Gjyqësor”
Komunikata për mbledhje të mbajtura	Komunikatat për mbledhjet e mbajtura publikohen në ueb-faqe, menjëherë pas mbajtjes së mbledhjes, megjithatë, të njëjtat nuk përmbajnë të dhëna më të detajuara për mbledhjen, përveç titullit të vendimit të miratuar (për shembull, pika e rendit të ditës është: Miratimi i rank-listës përfundimtare të kandidatëve për kryetarë/gjyqtarë, ndërsa komunikata për pikën e rendit të ditës është: Është marrë vendimi për miratimin e rank-listës përfundimtare të kandidatëve për kryetarë/gjyqtarë.)
Informacione për publikun	Pjesa – informacione për publikun nuk përditësohet dhe e njëjta përmban vetëm një publikim më të vjetër.
Prokurime publike	Lista e prokurimeve publike për vitin 2017 është e aksesshme në një dokument vetëm në pjesën “risi”. Fusha e veçantë e siguruar për prokurimet publike është e zbrazët.
Raporte tremujore për punën e gjykatave në RM	Këshilli Gjyqësor rregullisht, në çdo tre muaj, i shqyrton dhe vlerëson raportet, megjithatë, të njëjtit akoma nuk janë të aksesshëm në internet faqen, ndonëse është siguruar fushë për këtë.

⁶ Me aktet ligjore dhe nënligjore nuk është përcaktuar obligimi për publikimin e procesverbaleve nga mbledhjet, megjithatë, për shkak të sigurimit të parimit të transparencës dhe hapjes ndaj qytetarëve është me rëndësi që procesverbalet e të gjitha mbledhjeve publike të publikohen.

Llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë

Informimi proaktiv i publikut	Shënime të përgjithshme
Komunikata	<p>Në të shumtën e rasteve komunikatat kanë të bëjnë me mbajtjen e mbledhjes dhe me vendimet dhe konkluzionet nga mbledhjet e mbajtura.</p> <p>Janë publikuar komunikata për vizita pune në Gjykatën e Lartë Administrative, Gjykatën Administrative dhe në Gjykatën Themelore Shkup 2 Shkup, Gjykatën Themelore Strugë.</p> <p><u>Komunikatë për realizimin e vizitës së punës të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë në Gjykatën Themelore Gjevgjeli më datë 12.10.2017 – kjo komunikatë është publikuar nga kryetari i Këshillit Gjyqësor, si përgjigje dhe përgënjeshtër të spekulimeve të publikuara nga gazetarët.</u></p> <p><i>Komunikata për vizita pune jashtë vendit.</i></p> <p>Komunikatë për përsëritjen e procedurës kundër gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Shkup, pas aprovimit të aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në të cilin është konstatuar shkelje.</p>
Deklarata	<p>Zakonisht, pas mbledhjeve, nëse ka gazetarë, kryetari i KGJRM jep deklaratë dhe u përgjigjet pyetjeve të gazetarëve. Megjithatë, pas mbledhjes në të cilën u zgjodh kryetari i Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup, kryetari nuk dha deklaratë edhe krahas asaj se kishte interesim nga gazetarët.</p>

Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM

Llogaridhënia ndaj Kuvendit të RM	
Raportet vjetore	<p>Sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM-së, Këshilli Gjyqësor përpilon raport vjetor për punën e tij.</p> <p>Këshilli Gjyqësor duhet ta dërgoj Raportin në Kuvendin e RM-së në shqyrtim dhe miratim.</p> <p>Këshilli Gjyqësor duhet tua dërgoj raportin të gjitha gjykatave të RM-së.</p> <p>Raporti duhet të jetë publik.</p> <p>Këshilli Gjyqësor e dërgoi Raportin për vitin 2016 në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në muajin korrik të vitit 2017. I njëjti është i aksesshëm në internet faqen e KGJRM.</p>

	Kuvendi akoma nuk ka debatuar për Raportin.
--	---

Transparenca dhe llogaridhënia e siguruar përmes mbajtjes së mbledhjeve

	Numri i mbledhjeve të mbajtura	Numri i mbledhjeve të cilat kanë qenë të mbyllura për publikun ⁷
Gusht	4	2
Shtator	1	1
Tetor	3	1
Nëntor	3	1

Llogaridhënia sigurohet nëse institucionet dhe bartësit e funksioneve publike punojnë në interes të publikut dhe pengohet puna për interesa personale. Llogaridhënia nuk nënkupton vetëm llogaridhënie para një institucioni tjetër, por akoma më e rëndësishme është llogaridhënia ndaj qytetarëve.

Për këtë shkak, Këshillit Gjyqësor i RM-së vendimet e tij duhet t'i arsyetoj me argumente, me qëllim të rritjes së besimit të qytetarëve ndaj këtij trupit dhe me qëllim të zvogëlimit të ekzistimit të çfarëdo qoftë dyshimi për vendimet e tyre.

Në drejtim të transparencës së rritur, Këshillit Gjyqësor, duke filluar nga muaji korrik i vitit 2017, vendimet e tij për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve filloi t'i publikoj në kohë, vendimet e miratuara janë më të justifikuara, për dallim nga praktika paraprake, ndërsa vendimet me të cilat u krye zgjedhja e fundit e gjyqtarëve janë për përmbajtjesore, me më shumë elemente të publikuara nga biografite e kandidatëve, si dhe me tabela me pikë për kandidatët, e që deri më tani nuk ka ndodhur. Megjithatë, edhe krahas kësaj, në vendimet nuk përfshihen

⁷ Mbledhjet të cilat në këtë periudhë kohore ishin të mbyllura për publikun kryesisht kanë të bëjnë me Kërkesat për përcaktimin e kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjyqtarit.

elementët e llogaridhënies ndaj qytetarëve, e që nënkupton vendimet t'i përmbajnë edhe motivet pse ndonjë kandidat nuk është zgjedhur për gjyqtar ose për kryetar të gjykatës edhe pse ka qenë i rankuar më lartë në listën e kandidatëve të zgjedhur. Edhe pse në ligj ky obligim nuk është përcaktuar në mënyrë kategorike, megjithatë, vendimet e shkruara në detaje do ta përmbushnin interesimin publik dhe do ta rrisnin besimin në punën e anëtarëve të KGJRM.

EFEKTIVITETI I PUNËS SË KGJRM

Zbatimi i procedurës për zgjedhjen e gjyqtarëve

Këshilli zgjedh gjyqtar të gjykatës themelore nga rank-lista e kandidatëve të paraqitur nga Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë të cilët janë paraqitur në konkurs.

Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e gjyqtarëve

Zgjedhja:	Janë miratuar vendime për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të RM-së – 1 gjyqtar nga fusha penale, Gjykatës së Apelit Manastir – 1 gjyqtar nga fusha penale, Gjykatës së Apelit Shkup – 3 gjyqtarë nga të cilët 1 gjyqtar nga fusha penale dhe 2 gjyqtarë nga fusha civile.
Lista e kriterëve	<p>Kushtet për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatë më të lartë janë përcaktuar në Ligjin për gjykata edhe atë në nenin 45 dhe 46. Kriteret për zgjedhjen e gjyqtarëve janë përcaktuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RM-së në nenet 41, 42, 43, 44. Në përputhje me nenin 41 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM:</p> <p>Këshilli zgjedh gjyqtar në Gjykatën e Apelit, Gjykatën Administrative, Gjykatën e Lartë Administrative dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë nga kandidatët e paraqitur në konkurs të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara me Ligjin për gjykata dhe këtë Ligj, në mënyrë që kandidatët e paraqitur i rankon sipas specializimit të nevojshëm për plotësimin e vendit të gjyqtarit.</p> <p>Këshilli, për gjyqtar do të zgjedh person i cili posedon kualitete më të larta profesionale, i cili gëzon reputacion në kryerjen e funksionit të gjyqtarit, në bazë të kriterëve si vijojnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) njohuri profesionale dhe specializim në profesion dhe pjesëmarrje në trajnime të vazhdueshme; 2) raporti ndaj punës, me ç'rast merret parasysh respektimi i afateve ligjore për ndërmarrjen e veprimeve procesuale, respektimin e afateve ligjore për miratim, publikimin dhe përpilimin e vendimeve, raportin midis numrit të vendimeve të konfirmuara, të shfuqizuara ose të modifikuara në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura, numri i lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e përafërt të lëndëve që duhet t'i zgjidh gjyqtari në nivel mujor të përcaktuar nga Këshilli;

	<p>3) aftësia për zgjidhjen e çështjeve juridike, me ç’rast merret parasysh niveli i arritur i ligjshmërisë dhe drejtësisë së përcaktimit dhe vendimmarrjes gjyqësore, para së gjithash, në procedurat me mjete juridike;</p> <p>4) ruajtja e reputacionit të gjyqtarit dhe gjykatës, që përcaktohet nga mënyra e udhëheqjes së procedurës, komunikimit me palët dhe organet e tjera, ruajtjes së pavarësisë, paanshmërisë, konfidencialitetit, rëndësisë dhe sjelljes ndaj punës dhe jashtë saj;</p> <p>5) aftësia për t’u shprehur në mënyrë verbale dh me shkrim, e që mund të shihet përmes vendimeve të përpiluara dhe veprimit profesional gjyqësor;</p> <p>6) ndërmarrja e punës plotësuese në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit me pjesëmarrje në zgjidhjen e lëndëve të prapambetura;</p> <p>7) ndërmarrja e punës plotësuese gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit përmes mentorimit, edukimit dhe ngjashëm;</p> <p>8) raporti me bashkëpunëtorin dhe administratën gjyqësore dhe</p> <p>9) aftësia për kryerjen e detyrave me karakter udhëheqës.</p> <p>Nëse kandidati është nga radhët e gjyqtarëve, Këshillit siguron mendim nga gjykata dhe zbaton anketë anonime me të punësuarit në gjykatë ku kandidati e ushtron funksionin e gjyqtarit.</p> <p>Kryetari i gjykatës në bazë të mbledhjes së mbajtur të gjyqtarëve mendimin e dërgon deri te Këshilli.</p> <p>Nëse kandidati për gjyqtar për Gjykatën Administrative, përkatësisht Gjykatën e Lartë Administrative nuk është nga radhët e gjyqtarëve, Këshilli siguron mendim nga organi shtetëror në të cilin punon kandidati.</p> <p>Mënyrën e realizimit të anketës nga paragrafi 3 të këtij neni e rregullon Këshilli.</p> <p>Kriteret për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqtarëve për të cilët janë përcaktuar pikë dhe të cilët janë kusht për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatë më të lartë (avancim) janë dhënë në nenet nga 98 deri në 116, përkatësisht 131.</p>
<p>Vërejtje të përgjithshme</p>	<p>Edhe krahas kushteve ligjore dhe kriterëve të përcaktuara në Ligjin për gjykata dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RM-së, prapëseprapë, për gjyqtarë zgjidhet kandidati i cili do të fitojë shumicën e dy të tretave të votave nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor sipas nenit 42, paragrafit 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM-së, i cili parashikon se “Për gjyqtar është zgjedhur kandidati i cili ka fituar dy të tretat e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote”, ndërkaq me qëllim të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat gjatë zgjedhjes aplikohet neni 43 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor.</p> <p>Në mbledhjen e mbajtur në muajin nëntor, për herë të parë u publikuan dy lloje të rank-listave edhe atë njëra mazhoritare ndërsa lista tjetër sipas parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, e përbërë nga kandidatë të cilët janë pjesëtarë të bashkësive etnike, ndërsa gjatë votimit për zgjedhjen e gjyqtarëve, nga çdonjëra nga këto lista u zbatuan edhe rregullat e nenit 42 dhe 43 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor.</p>

Aplikimi i kriterëve për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave

Zgjedhja:	Janë miratuar vendime për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave edhe atë për Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup, Gjykatën e Apelit Shtip, Gjykatën Themelore Kumanovë, Gjykatën Themelore Tetovë dhe Gjykatën Themelore Resnje
Lista e kriterëve	<p>Kushtet për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës janë përcaktuar në Ligjin për gjykata edhe atë në nenin 47. Kriteret për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës janë përcaktuar në nenin 43 dhe 44 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM-së.</p> <p>Kriteret për monitorimin dhe vlerësimin e punës së kryetarëve të gjykatave janë përcaktuar në nenet nga 117 deri në 124, përkatësisht 131.</p>
Vërejtje të përgjithshme	Edhe krahas kushteve ligjore dhe kriterëve të përcaktuara në Ligjin për gjykata dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RM-së, për kryetar të gjykatës zgjidhet kandidati i cili do të fitojë shumicën e dy të tretave të votave nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor, duke e respektuar nenin 44 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM-së, i cili thotë: “Këshilli zgjedh kryetar të gjykatës nga kandidatët e paraqitur për gjyqtarë në konkursin për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës me dy të tretat e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote”, ndërkaq konform nenit 47 të Ligjit për gjykata. Për dallim nga zgjedhjet e deritanishme të kryetarëve të gjykatave, gjatë zgjedhjes së kryetarëve të gjykatave, të cilët janë zgjedhur në muajin nëntor, krahas kriterit numri më i madh i pikëve, merret parasysh edhe Programi i punës, si dhe përshtypja nga intervista e realizuar.

Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave

Shkarkimi dhe shqiptimi i masave disiplinore të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave nga KGJRM	
	Numri i procedurave
Gusht-nëntor 2017	/

<p>Vërejtje të përgjithshme</p>	<p>Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, vetëm në mbledhjet e mbajtura më datë 23.11.2017 dhe 24.11.2017, në të cilat u përjashtua publiku, vendosi si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. U miratuan vendime për ngritjen e procedurës për tri (3) kërkesa për përcaktimin e kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjyqtarit. 2. U miratua vendim me të cilin një (1) kërkesë për përcaktimin e kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjyqtarit u hodh poshtë si e paplotë. 3. U miratua vendim me të cilin një (1) kërkesë për përcaktimin e kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjyqtarit u hodh poshtë si e palejueshme. 4. U miratua vendim me të cilin u përcaktua raportues nga radhët e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë në lidhje me kërkesën e paraqitur për përcaktimin e kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjyqtarit nga Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Hapjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit.
--	--

Zgjedhja e gjyqtarëve-porotë

	Zgjedhja e gjyqtarëve-porotë
<p>Numri i gjyqtarëve-porotë</p>	<p>Konform Vendimit të KGJRM për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve-porotë në të gjitha gjykatat, për vitin 2015, janë parashikuar 1173 gjyqtarë-porotë</p>
<p>Vërejtje të përgjithshme</p>	<p>Në këtë periudhë, Këshilli Gjyqësor disa herë ka konstatuar zgjedhjen dhe ndërprerjen e funksionit gjyqtar-porotë në më tepër gjykata të shtetit. Si problem kryesor gjatë çdo zgjedhjeje konstatohet mungesë e gjyqtarëve porotë dhe numri i pamjaftueshëm i kandidatëve të cilët paraqiten në konkurset për zgjedhjen e gjyqtarit-porotë.</p> <p>Këshilli Gjyqësor, në këtë periudhë, dërgoi shkresa deri te Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave me kërkesë për takim me qëllim të gjetjes së zgjidhjes së këtij problemi.</p>

Transparenca përmes internet faqes:

Për dallim nga zgjedhjet paraprake të gjyqtarëve, vendimet për zgjedhje nga muaji nëntor përmbajnë informacione për të gjithë kandidatët të cilët janë paraqitur, me numrin e pikëve nga vlerësimi i vitit paraprak, të dhënat e shkurtra nga biografia, vitet e stazhit dhe përqindja e mbështetjes së shprehur nga të punësuarit në gjykatën në të cilën kandidati e ushtron funksionin e gjyqtarit në bazë të realizimit të ankesës anonime për çdo kandidat veç e veç.

Nga analiza e vendimeve për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatë më të lartë, të publikuara plotësisht në internet faqen, nuk mund të përcaktohet se sipas cilit parim janë rankuar kandidatët të cilët kanë pasur numër të njëjtë të pikëve, sepse ekzistojnë rankime me të cilat nga dy kandidatë me numër të njëjtë të pikëve nga vlerësimi i vitit të kaluar, kandidati i rankuar i parë është kandidati i cili ka më pak vite stazh dhe/ose më pak përqindje të shprehur nga mbështetja e të punësuarve në gjykatë.

Vendimet për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave, në rastin konkret të kryetarëve për GJA Shtip, GJTH Kumanovë, GJTH Tetovë dhe GJTH Resnje e përmbajnë vetëm numrin e pikëve nga vlerësimi i kandidatëve. Në të gjitha këto raste kandidat i parë është zgjedhur në listën e cila ka numër më të madh të pikëve nga vlerësimi. Ndërsa vendimi për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup ku është zgjedhur kandidati i gjashtë nga gjithsej shtatë kandidatët e rankuar, përmban informacione të detajuara për të gjithë kandidatët si: numri i pikëve, gjykata në të cilën punon, biografia dhe stazhi i gjyqtarit.

Gjatë zgjedhjeve nga vitet e kaluara, zgjedhja e kryetarëve të gjykatave është kryer në përputhje me numrin e fituar të pikëve nga vlerësimi, kështu që kandidati i cili ka numër më të madh të pikëve, në raport me kandidatët e paraqitur të tjerë, do të zgjidhet për kryetar të gjykatës. Në mënyrë analoge me këtë janë zgjedhur edhe gjyqtarët në gjykatat më të larta.

Transparenca dhe llogaridhënia e mbledhjeve:

Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve, në muajin nëntor të vitit 2017 gjatë kohës së prezantimit të tyre në mbledhje, nga ana e anëtarëve të Komisionit, krahas numrit të pikëve u prezantuan edhe kriteret e tjera të përcaktuara në nenin 41 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor. Nëse deri më tani gjithnjë zgjidheshin kandidatë të cilët kishin numër më të madh të pikëve, në këtë rast u zgjodhën kandidatë të cilët, në përputhje me rank-listën nuk janë me numër më të madh të pikëve. Së këtejmi, në rastet kur kandidati i parë nuk e fitonte dy të tretën e shumicës së votave iu qas zgjedhjes sipas radhës së kandidatëve konform rank-listës. Njëkohësisht, pasi një kandidat për gjyqtar do ta fitonte shumicën e dy të tretës së nevojshme të votave, nuk vazhdohej me votim për kandidatët e tjerë të cilët janë në rank-listën për gjyqtarë, por ai kandidat shpallej i zgjedhur.

Në disa raste për herë të parë anëtarët e Këshillit Gjyqësor i theksuan përqindjet e mbështetjes së fituar nga anketa e realizuar, vitet e stazhit dhe programi për punë gjatë zgjedhjes së kryetarit të gjykatës si element i rëndësishëm për shkak të të cilët për ndonjë gjyqtarë të caktuar do të votojnë “Pro”. Megjithatë nuk kishte arsyetim pse për disa gjyqtarë të caktuar do të votohet “Kundër”, edhe pse kanë numër më të madh të pikëve, më shumë vite përvojë pune dhe përqindje më të lartë të mbështetjes. Si përgjigje në pyetjen: pse nuk ka arsyetim për votimin “Kundër”, një pjesë e anëtarëve theksuan se në momentin e zgjedhjes një gjë e këtillë nuk është obligim ligjor.

Efektiviteti i punës së Këshillit Gjyqësor:

Për zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën Supreme dhe në Gjykatën e Apelit, edhe pse u shpall konkurs për 2 gjyqtarë në Gjykatën Supreme dhe 4 në Gjykatën e Apelit, ndonëse në konkurs ishin paraqitur 7 gjyqtarë për Gjykatën Supreme dhe më shumë se 50 për Gjykatën e Apelit – Shkup të cilët i plotësonin kushtet në përputhje me Ligjin, megjithatë, për Gjykatën Supreme u zgjodh vetëm 1 gjyqtar edhe atë nga lista e kandidatëve sipas parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, edhe pse kishte nevojë për 2 gjyqtarë, ndërsa në Gjykatën e Apelit nga 4 gjyqtarë të nevojshëm u zgjodhën tre gjyqtarë.

Edhe pse kishte një numër të madh të kandidatëve të paraqitur për gjyqtarë me rank-lista të miratuara prapëseprapë Këshilli Gjyqësor nuk i plotësoi të gjitha vendet e nevojshme për gjyqtarë konform konkursit paraprakisht të shpallur, me çka vihet në pikëpyetje efektiviteti dhe efikasiteti i Këshillit Gjyqësor, meqë në periudhën e ardhshme duhet ta përsërisë procedurën për zgjedhjen e gjyqtarëve.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E KËSHILLIT PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE DHE PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË GJYQTARIT

Aspekti informativ i ueb-lokacionit të Këshillit të Fakteve dhe llogaridhënia e siguruar ndaj publikut të gjerë

Aspekti informativ i ueb lokacionit të Këshillit të Fakteve

Këshilli i fakteve **nuk ka ueb – faqe të vet** meqë Këshilli Buxhetor Gjyqësor nuk ka realizuar prokurim përkatës për të njëjtën. Këshilli i Fakteve raportet për punën e tij ua dërgon përmes postës elektronike mediave dhe Institutit për të Drejtat e Njeriut. Në periudhën e kaluar, veçanërisht në dokumentin strategjik të Qeverisë, u theksua ndërprerja e punës së këtij organi.⁸

Sigurimi i llogaridhënies ndaj publikut të gjerë

Kryetari i Këshillit të Fakteve, përmes komunikatave deri te publiku komunikoi me publikun. Për shkak të suspendimit të paralajmëruar të punës së këtij organi me miratimin nga ana e Qeverisë të Propozim ligjit për suspendimin e Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Përgjegjësinë e Gjyqtarit, kryetari i Këshillit të Fakteve dërgoi komunikatë deri te publiku në të cilën i thekson shkaqet për nevojën e ekzistimit të një organi të këtillë dhe jep rekomandime për ndarjen e udhëheqjes së procedurave disiplinore nga vendimmarrja, nëse megjithatë suspendohet funksionimi i këtij organi.

⁸ Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Plani 3-6-9, në pjesën e reformave gjyqësore. I aksesshëm në: <http://vlada.mk>.

EFEKTIVITETI I PUNËS SË KËSHILLIT TË FAKTEVE

Shqyrtimi i iniciativave të paraqitura

Shqyrtimi i iniciativave të paraqitura

Konform Ligjit, mbledhjet e Këshillit të Fakteve janë të hapura për publikun. Publiku mund të përjashtohet vetëm me vendim të Këshillit, me qëllim të mbrojtjes së reputacionit dhe integritetit të gjyqtarit ose të kandidatit për gjyqtar. Megjithatë, në praktikë, **mbledhjet janë të fshehta**, meqë edhe sipas Rregullores së punës procedura për ngritjen e përgjegjësisë së gjyqtarit nuk është publike.

Brenda kësaj periudhe nuk është mbajtur **seancë publike**.

Procedurat sipas iniciativave të paraqitura për përgjegjësinë e gjyqtarit deri te Këshilli i Fakteve

Procedurat sipas iniciativave të paraqitura për përgjegjësinë e gjyqtarit deri te Këshilli i Fakteve				
	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor
Numri i parashtresave të paraqitura nga ana e qytetarëve, personave juridikë, në nivel mujor	33	37	50	47
Mbledhje të mbajtura të Këshillit të Fakteve në të cilat janë shqyrtuar parashtresat e paraqitura	1	3	7	4
Kërkesë për inicimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose të kryetarit të gjykatës deri te Këshilli Gjyqësor i RM-së	1			

	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor
Veprime sipas zërit të dëgjuar	1 2	/		1

Rekomandime për transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e Këshillit të Fakteve:

Nëse suspendohet ky organ, atëherë duhet të sigurohet ndarja e udhëheqjes së procedurës për përgjegjësi disiplinore nga vendimmarrja sipas procedurës së zbatuar para Këshillit Gjyqësor, ndërsa shkarkimi të jetë si një lloj i sanksionit më të rëndë konform procedurës së zbatuar disiplinore.

Procedura paraprake e inicimit dhe vendimmarrjes nga Këshilli Gjyqësor ishte vërejtja kryesore e rekomandimit të GREKO sipas pikës 169⁹ që ka të bëjë me nevojën që procedura disiplinore për gjyqtarë të revidohet në atë mënyrë që shkeljet të jenë çështje të procedurës së veçantë disiplinore, ndërkaq duke i pasur parasysh parimet e pavarësisë gjyqësore, trupi i cili do ta inicioj procedurën dhe do ta zhvilloj hetimin lidhur me procedurën disiplinore të jetë i ndarë nga trupi i cili do të vendos për sanksionet.¹⁰

Këshilli për Përcaktimin e Fakteve u formua me qëllim që të sigurohet procedurë në dy shkallë gjatë procedurës disiplinore. Megjithatë, Ligji u miratua me procedurë urgjente dhe pa u harmonizuar me Kushtetutën e RM-së, kjo kontribuoi që të ketë reagime nga publiku ekspert, si dhe kritika nga Komisioni i Venecias.¹¹

9 GRECO-Group of States against Corruption, Raporti i GREKO [https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/GrecoEval4\(2013\)4_TheFYROMacedonia_EN.pdf](https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/GrecoEval4(2013)4_TheFYROMacedonia_EN.pdf), f. 39.

10 Ibid.

11 Jurisprudenca dhe të drejtat themelore në Republikën e Maqedonisë, “Rrjeti 23”, Komiteti i Helsinkit, viti 2015.